



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT

Nr. 496 Akti

Nr. 701 Vendimi
Tiranë, më 25.9.2023

V E N D I M

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, i përbërë nga:

Genta Tafa (Bungo)	Kryesuese
Valbona Sanxhaktari	Relatore
Lulzim Hamitaj	Anëtar

në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, asistuar nga sekretarja gjyqësore, në datën 18.7.2022, ora 10:00, në Pallatin e Koncerteve (ish-Pallati i Kongreseve), salla B, kati 0 (*underground*), Tiranë, mori në shqyrtim në seancë dëgjimore publike çështjen që i përket:

SUBJEKTI I RIVLERËSIMIT: **Znj. Jurida Bajraktari**, me detyrë ndihmëse ligjore në Gjykatën Administrative të Apelit Tiranë.

OBJEKTI: **Rivlerësimi kalimtar i subjektit të rivlerësimit.**

BAZA LIGJORE: **Neni 179/b i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe nenet A, Ç, D, DH, E dhe Ë të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë;**

Ligji nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

TRUPI GJYKUES I KOMISIONIT TË PAVARUR TË KUALIFIKIMIT,

pasi analizoi të gjithë dokumentacionin e administruar gjatë hetimit administrativ së bashku me provat shkresore, si dhe shqyrtoi dhe analizoi çështjen në tërësi dhe sjelljen e subjektit gjatë procesit të rivlerësimit kalimtar ndaj saj,

V Ë R E N:

I. RRETHANAT E ÇËSHTJES

1. Znj. Jurida Bajraktari është subjekt i rivlerësimit për shkak të pozicionit të saj si ndihmëse ligjore në Gjykatën Administrative të Apelit Tiranë. Bazuar në pikën 4 të nenit 4 dhe në pikën 2 të nenit 14 të ligjit nr. 84/2016, si dhe në rregulloren “Për procedurat e zhvillimit të shortit”, Komisioni i Pavarur i Kualifikimit në vijim ka hedhur shortin në datën 15.6.2020, nga i cili rezultoi se subjekti i rivlerësimit i është nënshtruar procesit të rivlerësimit nga trupi gjykues nr.1.

2. Në vijim, anëtarët deklaruan lidhur me konfliktin e interesit dhe caktuan kryesuese znj. Genta Tafa (Bungo). Vëzhguese ndërkombëtare për këtë çështje është caktuar znj. Elka Ermenkova.

3. Komisioni ka njoftuar subjektin e rivlerësimit për përbërjen e trupit gjykues, për të cilin ajo ka deklaruar se nuk ka konflikt interesi me anëtarët e tij.

4. Bazuar në nenet 33, 39 dhe 43 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, me fillimin e hetimit administrativ janë administruar nga relatori raportet e vlerësimit të hartuara nga Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (në vijim ILDKPKI), Autoriteti Kombëtar për Sigurinë e Informacionit të Klasifikuar (në vijim AKSIK), Këshilli i Lartë Gjyqësor (në vijim KLGJ) dhe Shkolla e Magjistraturës.

5. Relatorja e çështjes ka ndjekur procedurat ligjore të përcaktuara nga neni 14, pika 5 e ligjit nr. 84/2016. Procesi i rivlerësimit ka nisur me një hetim administrativ të thellë dhe të gjithanshëm, me qëllim vlerësimin e të gjitha fakteve dhe rrethanave të nevojshme për këtë procedurë rivlerësimi.

6. Në datën 27.6.2022, trupi gjykues, në prani të vëzhgueses ndërkombëtare, diskutoi mbi rezultatet e hetimit, provat e mbledhura dhe, në vijim, vendosi të përfundojë hetimin kryesisht për tre kriteret e rivlerësimit për znj. Jurida Bajraktari. Komisioni njoftoi nëpërmjet postës elektronike subjektin e rivlerësimit, znj. Jurida Bajraktari, për përfundimin e hetimit kryesisht dhe kalimin e barrës së provës, si dhe i bëri me dije të drejtat në bazë të ligjit për t’u njohur me dosjen dhe për të paraqitur prova dhe shpjegime të tjera për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit.

7. Subjekti i rivlerësimit, ka kërkuar shtyrjen e afatit për dorëzimin e shpjegimeve për rezultatit e hetimit, pasi ishte në pamundësi objektive për të siguruar, brenda afatit të caktuar nga Komisioni, dokumentacionin e gjykuar prej saj si të domosdoshëm për të realizuar një mbrojtje efektive. Komisioni ka pranuar kërkesën e subjektit të rivlerësimit, duke e shtyrë afatin për dorëzim dokumentacioni deri në datën 14.7.2022.

8. Subjekti i rivlerësimit ka paraqitur prapësimet dhe provat mbi rezultatet e hetimit administrativ në datën 14.7.2022, të cilat u pranuan dhe u morën në shqyrtim nga Komisioni.

9. Seanca dëgjimore me subjektin e rivlerësimit u zhvillua në datën 18.7.2022, ora 10:00, në Pallatin e Koncerteve në prani të vëzhguesit ndërkombëtar. Gjatë seancës dëgjimore, subjekti i rivlerësimit ishte prezente personalisht e shoqëruar edhe nga përfaqësuesja ligjore, av. R. Z., dhe paraqiti dokumentacion shtesë, i cili është administruar në dosjen e subjektit të rivlerësimit. Në përfundim të shpjegimeve dhe parashtrimeve, subjekti i rivlerësimit kërkoi nga Komisioni konfirmimin në detyrë.

10. Pas përfundimit të seancës dëgjimore të datës 18.7.2022, trupi gjykues u mbledh në dhomë këshillimi në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar dhe, në bazë të shkronjës “b” të pikës 1 të nenit 58, nenit 44/b, si dhe të pikës 1 të nenit 60 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, duke vlerësuar problematikat në kriterin e vlerësimit të aftësive profesionale, me vendim të ndërmjetëm, vendosi: *“Pezullimin nga detyra të znj. Jurida Bajraktari për një periudhë njëvjeçare dhe detyrimin për të ndjekur programin e trajnimit, sipas kurrikulave të miratuara nga Shkolla e Magjistraturës”*.

11. Vendimi i ndërmjetëm i Komisionit i u njoftua subjektit të rivlerësimit në seancën publike të datës 20.7.2022, në të cilën ajo ishte prezente së bashku me përfaqësuesen e saj ligjore dhe që u zhvillua në përputhje me nenin 55 të ligjit nr. 84/2016, nën prezencën e vëzhguesit ndërkombëtar gjithashtu.

12. Vendimi i ndërmjetëm i Komisionit nr. 496 akti, datë 20.7.2022, *“Pezullimin nga detyra të znj. Jurida Bajraktari dhe detyrimin e saj për të ndjekur programin njëvjeçar të Shkollës së Magjistraturës”*, iu njoftua palëve dhe u publikua në datën 4.8.2022, gjithashtu i u dërgua Shkollës së Magjistraturës.

13. Në përfundim të programit të trajnimit, Shkolla e Magjistraturës, me shkresën nr. *** prot., datë 21.7.2023, ka njoftuar Komisionin për rezultatet e provimit përfundimtar të subjektit të rivlerësimit, nga ku rezulton përfundimi i programit me vlerësimin në nivelin “Mirë”.

14. Pas administrimit të këtyre rezultateve, trupi gjykues, u mblodh në dhomë këshillimi në datën 21.9.2023, në prani të vëzhguesit ndërkombëtar, diskutoi, vlerësoi dhe vendosi se subjekti i rivlerësimit ka arritur nivelin kualifikues të kërkuar nga neni 59, pika 1, shkronja “c” e ligjit nr. 84/2016, si dhe ka arritur një nivel të besueshëm në vlerësimin e pasurisë dhe atë të figurës e, në vijim, trupi gjykues vendosi ta konsiderojë të përfunduar procesin e rivlerësimit për subjektin e rivlerësimit, znj. Jurida Bajraktari, për të tria kriteret e rivlerësimit.

15. Seanca e shpalljes së vendimit u zhvillua në Pallatin e Koncerteve, në datën 25.9.2023, ora 09:45, me pjesëmarrjen e subjektit të rivlerësimit, në prezencë edhe të vëzhguesit ndërkombëtar.

II. PROCESI I RIVLERËSIMIT NGA KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT

16. Procesi i rivlerësimit, i cili kryhet nga Komisioni, është një proces kushtetues që mbështetet në nenin 179/b dhe Aneksin e Kushtetutës, si dhe në ligjin nr. 84/2016. Anëtarët e Komisionit hetojnë dhe vlerësojnë të gjitha faktet dhe rrethanat e nevojshme për procedurën e rivlerësimit. Ata kanë të drejtë të çmojnë në tërësi, sipas bindjes së tyre të brendshme, çdo *indicie* lidhur me rrethanat e çështjes.

17. Referuar vendimit nr. 2/2017 të Gjykatës Kushtetuese dhe kreut VII të ligjit nr. 84/2016, Komisioni, në kryerjen e funksionit të tij kushtetues, realizon një proces të mirëfilltë kontrolli dhe rivlerësimi të pabazuar në përfundimet e paraqitura nga organet e tjera ndihmëse¹.

18. Bazuar në nenet 45, 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016, Komisioni kreu hetim dhe vlerësim të të gjitha fakteve dhe rrethanave të nevojshme për procedurën e rivlerësimit, duke marrë në analizë:

- a) raportin e dorëzuar në Komision nga ILDKPKI-ja dhe provat e dorëzuara nga subjekti pranë këtij institucioni në Deklaratën e pasurisë për rivlerësimin kalimtar *Vetting*, në përputhje me nenin 33 të ligjit nr. 84/2016;
- b) raportin e dorëzuar në Komision nga AKSIK-ja së bashku me dokumentacionin shoqërues, në përputhje me nenin 39 të ligjit nr. 84/2016;
- c) informacionin e përditësuar nga institucionet ligjzbatuese sipas përcaktimeve ligjore;
- ç) raportin e dorëzuar në Komision nga KLGJ-ja, së bashku me materialin shoqërues, në përputhje me nenin 43 të ligjit nr. 84/2016 si dhe atë nga Shkolla e Magistraturës;
- d) dokumentet shkretores të vëna në dispozicion nga organet publike dhe private, në përputhje me nenet 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016;
- dh) deklaratimet e vëna në dispozicion nga subjekti i rivlerësimit nëpërmjet komunikimit shkretores, elektronik dhe gjatë seancës dëgjimore.

A. VLERËSIMI I PASURISË

19. Në Deklaratën e pasurisë *Vetting*, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar pasuritë e analizuar si më poshtë.

20. **Automjet tip “***”,** vit prodhimi 2010, blerë me Kontratën e Shitblerjes nr. ***, datë 12.8.2011, në vlerën 2.211.235 (dy milionë e dyqind e njëmbëdhjetë mijë e dyqind e tridhjetë e pesë) lekë (ekuivalent i shumës 15.800 euro), me pjesë takuese 50%.

20.1 Burimi i krijimit sipas Deklaratës *Vetting*: të ardhurat nga biznesi i bashkëshortit “***” për vitet 2001 – 2007, Prishtinë, Kosovë, në masën 130.800 (njëqind e tridhjetë mijë e tetëqind) euro. Sipas informacionit të biznesit rezulton se shtetasi R. H. ka themeluar në datën 1.8.2002 biznesin individual “***”.

¹ Vendimi nr. 2/2017 i Gjykatës Kushtetuese (cit): “41. Për rrjedhojë, gjykata vlerëson se pretendimi se organet ekzistuese zëvendësojnë organet e reja të rivlerësimit, është i pabazuar. Sipas nenit 179/b, pika 5, të Kushtetutës, rivlerësimi kryhet nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, kurse sipas nenit 4/2 të ligjit: “Komisioni dhe Kolegji i Apelit janë institucionet që vendosin për vlerësimin përfundimtar të subjekteve të rivlerësimit”. Pavarësisht formulimit të kësaj dispozite ajo nuk mund të lexohet në mënyrë të shkëputur, por në harmoni me dispozitat e tjera ligjore që përcaktojnë në mënyrë të detajuar kompetencat e organeve të përfshira në proces, si dhe kompetencat që kryen vetë Komisioni i Pavarur i Kualifikimit gjatë këtij procesi”.

Hetimi i kryer nga Komisioni

20.2 Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor, me shkresën nr. *** prot., datë 14.9.2020, ka konfirmuar për Komisionin se automjeti me targë *** është i regjistruar në pronësi të shtetasit R. G. H. (person i lidhur). Nga shqyrtimi i dokumentacionit të DPSHTRR-së rezulton se automjeti është blerë nga personi i lidhur me subjektin e rivlerësimit, shtetasi R. H., me Kontratë Shitjeje në datën 12.8.2011, në vlerën 2.211.235 (dy milionë e dyqind e njëmbëdhjetë mijë e dyqind e tridhjetë e pesë) lekë (ekuivalent i shumës 15.800 euro) në njësinë e shitjes së automjeteve “***”. Blerja është e shoqëruar me faturën tatimore të shitjes, e cila mban datën 12.8.2011.

20.3 Subjekti i rivlerësimit është pyetur nga Komisioni² lidhur me mënyrën e kryerjes së pagesës dhe nëse e ka disponuar *cash* apo në llogari bankare këtë shumë³, e cila ka deklaruar se: *“Sqaroj se shuma 2.211.235 (dy milionë e dyqind e njëmbëdhjetë mijë e dyqind e tridhjetë e pesë) lekë për blerjen e automjetit në vitin 2011 është kryer nga bashkëshorti im dhe, për sa i përket mënyrës së pagesës, shumën në fjalë e ka derdhur në arkën e shoqërisë, ku është blerë automjeti dhe është pala shitëse që e ka disponuar këtë shumë në llogarinë bankare të cituar në kontratën e shitjes së automjetit. Kjo shumë e deklaruar (të ardhurat) nga bashkëshorti im është mbajtur cash”*.

20.4 E pyetur nga Komisioni⁴ se si janë përdorur të ardhurat e deklaruara nga aktiviteti tregtar i bashkëshortit në Kosovë, ajo është shprehur se: *“Të ardhurat në shumën 130.800 (njëqind e tridhjetë mijë e tetëqind) euro (për periudhën 2001 – 2007) janë të ardhura që janë përdorur për shpenzimet e jetesës dhe blerjen e një automjeti me vlerën 2.211.235 (dy milionë e dyqind e njëmbëdhjetë mijë e dyqind e tridhjetë e pesë) lekë në vitin 2011. Gjithashtu, sqaroj se kjo vlerë monetare nuk është gjendje në ndonjë llogari bankare apo cash në shtëpi, pasi është një vlerë monetare, e cila është përdorur për shpenzimet e jetesës”*.

20.5 Subjekti i rivlerësimit ka dorëzuar në ILDKPKI⁵ dokumentacion, ku rezulton se shtetasi R. H., në datën 15.4.2002, në Kosovë ka regjistruar aktivitetin tregtar “bar - restorant”, me emrin “***”. Në dokumentacionin e paraqitur nuk ka informacion lidhur me periudhën që ka operuar ky aktivitet, si dhe lidhur me të ardhurat dhe fitimet e përfituara.

20.6 Për të kryer analizën financiare lidhur me burimin, Komisioni i ka kërkuar subjektit të rivlerësimit të paraqesë dokumentacion për të ardhurat e përfituara nga biznesi i bashkëshortit në Kosovë, të cilat kanë shërbyer si burim për blerjen e pasurisë automjet, referuar deklarimeve të vetë subjektit në Deklaratën *Vetting*. Ajo është pyetur disa herë nga Komisioni, por nuk ka paraqitur dokumentacion provues dhe se ato mbeten vetëm në nivel deklarativ.

20.7 Nga analiza e lëvizjeve të llogarive të subjektit të rivlerësimit dhe bashkëshortit të saj nuk rezultojnë likuiditete në vlera të konsiderueshme të krijuara deri në vitin 2011, të cilat mund të kenë shërbyer për blerjen e këtij automjeti.

20.8 Subjekti i rivlerësimit është pyetur nga Komisioni⁶ lidhur me përdorimin e të ardhurave nga pagat e deklaruara në Deklaratën *Vetting*, ku deklaroi se këto të ardhura janë përdorur për shpenzime jetese dhe se nuk janë përdorur për krijimin e ndonjë pasurie.

20.9 Në përfundim të rezultateve të hetimit, subjektit të rivlerësimit iu kalua barra e provës për të provuar burimin e të ardhurave të përdorura për krijimin e pasurisë automjet dhe vërtetësinë e deklarimeve të saj në Deklaratën *Vetting*.

20.10 Pas kalimit të barrës së provës, subjekti u shpreh se: *“Aktiviteti tregtar i ushtruar nga bashkëshorti im, për të cilin është përfituar shuma në total prej 130.800 (njëqind e tridhjetë mijë e tetëqind) euro, është shtrirë përgjatë periudhës kohore 2001 – 2007, pra 10 vite përpara se unë të kryeja deklarinë e pasurisë (për shkak të ligjit nr. 84/2016) për Deklaratën *Vetting*,*

² Shihni përgjigjen nr. 2 në pyetësonin e datës 1.10.2021.

³ Shihni përgjigjen nr. 1 në pyetësonin e datës 6.10.2021.

⁴ Shihni përgjigjen nr. 1 të pyetësonit të datës 1.10.2021.

⁵ Shihni dosjen e ILDKPKI-së ku është depozituar certifikatë regjistrimi dhe ekstrakt për aktivitetin.

⁶ Shihni përgjigjen nr. 5 të pyetësonit të datës 1.11.2021.

pranë ILDKPKI-së në datën 24.1.2017. Duke qenë se afati kohor i ushtrimit të aktivitetit tregtar nga bashkëshorti im (që përkon me vitin 2007), në të cilin është krijuar pasuria monetare, e cila ka qenë burimi i blerjes së automjetit deri në datën e plotësimit të Deklaratës Vetting (24.1.2017) kanë kaluar rreth 10 vite, deklaroj se ne nuk kemi ruajtur pasqyra financiare, regjistra tatimorë, deklaratë tatimore. Gjithashtu, ju bëj me dije se ky aktivitet tregtar është ushtruar me vendndodhje ... krahina e Kosovës e administruar nga ***, mbi Rezolutën 1244(1999) e Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara. Referuar legjislacionit dhe rregulloreve me të cilat administrohej kjo krahinë (sipas Rezolutës nr. 1244/1999) afati për ruajtjen e pasqyrave financiare, regjistrave tatimorë, deklaratave tatimore, etj., është afati kohor prej 6 vitesh pas përfundimit të periudhës tatimore, kur ka lindur një detyrim i tillë tatimor përkatës”.

20.11 Komisioni çmon se argumentet e subjektit duhet të konsiderohen. Nga hetimi rezulton se pasuria është krijuar vite përpara fillimit të punës së subjektit të rivlerësimit pranë Gjykatës Administrative të Apelit dhe përpara deklarimit të interesave pasurorë të saj për efekt të Deklaratës Vetting. Komisioni nuk konstatoi problematika dhe nuk pati dyshime për hetime të mëtejshme në lidhje me këtë pasuri.

21. Deklaruar adresë banimin në Njësinë Administrative Nr. *, rruga “****”, pallati nr. ***, Tiranë, si dhe në Njësinë Administrative Nr. ***, rruga “****”, kompleksi ***, ***, Tiranë.** Nga vlerësimi i Deklaratës Vetting rezulton se subjekti i ka deklaruar këto adresa banimi në rubrikën përkatëse, por nuk ka deklaruar këto pasuri (në përdorim) apo të dhëna të tjera lidhur me shpenzime të kryera prej saj.

Hetimi i kryer nga Komisioni

21.1 Komisioni ka kryer verifikimin në sistemin *online* në ASHK, nga ku ka rezultuar se pasuria apartament me sipërfaqe shfrytëzimi 89.1 m² ndodhet në z. k. ***, me nr. ***, në rrugën “****”, Tiranë. Këto të dhëna përkojnë me adresën e deklaruar nga subjekti i rivlerësimit në Deklaratën Vetting dhe në pyetësonin standard. Nga verifikimi i dokumentacionit *online* të ASHK-së rezulton se:

a) Pasuria e llojit apartament me sipërfaqe 89.1 m², z. k. ***, është regjistruar në pronësi të shoqërive tregtare “****” sh.p.k. dhe “****” sh.p.k. sipas vërtetimit hipotekor nr. ***, datë 26.6.2007.

b) Në datën 14.8.2007 është lidhur Kontrata e Shitblerjes së pronës së paluajtshme nr. *** rep., nr. *** kol., me palë shitëse shoqëritë tregtare “****” sh.p.k. dhe “****” sh.p.k. dhe palë blerëse I. dhe M. M., si dhe në datën 30.8.2007 është paguar prej shoqërisë “****” sh.p.k. taksa e pronës së shtetasit I. M. në vlerën 89.100 (tetëdhjetë e nëntë mijë e njëqind) lekë.

c) Nga kartela e pasurisë së paluajtshme konstatohet se pronësia e kësaj pasurie ka kaluar në emër të shtetasve I. dhe M. M. në datën 4.9.2007.

21.2 Subjekti rivlerësimit ka sqaruar⁷ Komisionin se shpenzimet për qiranë i kanë përballuar prindërit e bashkëshortit (burimet e ligjshme të prindërve të bashkëshortit janë detajuar në seksionin “Gjetje të tjera”).

21.3 Në përfundim të rezultateve të hetimit, Komisioni konstatoi se:

- Subjekti i rivlerësimit nuk ka deklaruar në Deklaratën Vetting posedimin e apartamentit me qira dhe shpenzimet përkatëse të kryera për të, duke pasur detyrim ligjor për ta deklaruar.

- Deklarimet e subjektit për pagesën e shpenzimeve të qirasë në pyetësonët përkatës nuk përputhen me dokumentacionin e paraqitur nga vetë ajo.

21.4 Subjekti ka bashkëlidhur në prapësime një Deklaratë Noteriale nr. *** rep., nr. *** kol., datë 13.7.2022, të vjehrrës së saj për mbulimin e shpenzimeve të qirasë dhe faturave të energjisë elektrike dhe të ujit.

⁷ Shihni përgjigjen nr. 3, datë 8.10.2021 për pyetësonin e datës 1.10.2021.

21.5 Subjekti nuk ka dhënë shpjegime në lidhje me faktin që nuk e ka deklaruar në Deklaratën *Vetting* si pasuri në posedim të saj apartamentin e ndodhur në rrugën “****”, ku ajo banon me qira nga viti 2015. Kjo pasuri deklarohet vetëm si adresë banimi.

21.6 Megjithatë, në vlerësim të të gjitha rrethanave, Komisioni çmon se ky mosdeklarim nuk është bërë në mënyrë të qëllimshme nga subjekti për të fshehur diçka tjetër, përderisa është deklaruar si adresë banimi në Deklaratën *Vetting* dhe janë dhënë shpjegime të mëtëjshme në pyetësin standard në lidhje me pronarin e pasurisë dhe shpenzimet mujore të qirasë.

21.7 Në lidhje me deklaratimet se shpenzimet e qirasë dhe të faturave të energjisë elektrike e të ujit janë mbuluar nga vjehri dhe vjehrra e saj, nuk kanë arritur të provohen me dokumente dhe mbeten deklarative, megjithëse duket se këta të fundit mund të kenë pasur mundësi financiare për t’i mbuluar ato, si rrjedhojë e bizneseve që ata zotërojnë. Komisioni nuk ka kryer analizë financiare të mirëfilltë për prindërit e bashkëshortit për shkak të statusit të subjektit (atë të ndihmësës ligjore), si dhe të mungesës së deklaratimeve periodike para dhe pas Deklaratës *Vetting*.

21.8 Në lidhje me këtë pasuri nuk u konstatuan problematika të tjera, e nuk pati dyshime për hetime të mëtëjshme në kuadër të procesit të rivlerësimit kalimtar.

22. Kredi konsumatore në shumën 1.000.000 (një milion) lekë në Credins Bank. Subjekti i rivlerësimit ka deklaruar në Deklaratën *Vetting* përfitim të një kredie standarde në shumën 1.000.000 (një milion) lekë. Kjo kredi rezulton me kredidhënës Credins Bank sipas Kontratës së Kredisë nr. ***, datë 7.10.2016, me afat deri në datën 6.10.2020, afat 4-vjeçar, interesi 7.5% në vit dhe këst mujor në vlerën 24.999 (njëzet e katër mijë e nëntëqind e nëntëdhjetë e nëntë) lekë.

22.1 Subjekti i rivlerësimit nuk ka deklaruar në Deklaratën *Vetting* arsyen për të cilën është marrë kredia prej saj pranë Credins Bank në vitin 2016 dhe mënyrën se si është përdorur kjo kredi.

Hetimi i kryer nga Komisioni

22.2 Subjekti i rivlerësimit ka sqaruar⁸ për Komisionin arsyen e lidhjes së kontratës së kredisë në Credins Bank, në datën 7.10.2016, qëllimin e detyrimit financiar⁹ dhe dokumentacionin shoqërues, si vijon: “...kredia është marrë për të mbuluar shpenzime të cilat i kam bërë për disa riparime për banesën në të cilën banoj me qira. Kjo banesë është lënë në vazhdimësi me qira nga qiradhënësi dhe kishte nevojë për disa rregullime, si: lysterje me bojë e banesës, ndërrimin e disa pajisjeve elektrike (si priza, llamba) dhe të pajisjeve sanitare (si rubinete uji), të cilat ishin në gjendje jo të mirë, të amortizuara. Pjesën tjetër të mbetur të kredisë e kam mbajtur cash, duke vazhduar shlyerjen e kredisë sipas kësteve të parashikuara në kontratën e vitit 2016 me Credins Bank. Gjithashtu ju sqaroj se kjo kredi e marrë nga ana ime është kredi konsumatore (personale), është shlyer brenda afateve të parashikuara në kontratën mes meje, si debitor, dhe Credins Bank si kreditor”.

22.3 Subjekti i rivlerësimit sqaron për Komisionin¹⁰ se e ka përdorur kredinë për disa riparime në shtëpinë me qira, pa përcaktuar shumën e shpenzuar dhe se pjesën tjetër e ka mbajtur cash në shtëpi, por në pyetësin standard nuk deklaroi shpenzime për riparim apo arredim shtëpie dhe as në Deklaratën *Vetting* nuk deklaroi gjendje cash në banesë.

22.4 Credins Bank ka përcjellë¹¹ për Komisionin kontratat e nënshkuara midis palëve dhe praktikën e aprovimit të kredisë konsumatore nga kjo bankë. Nga sa vijon, rezultoi se është plotësuar nga subjekti i rivlerësimit formulari i aplikimit të kredisë, ku ka aplikuar për shumën 1.000.000 (një milion) lekë me qëllim kredie për mobilim dhe, më tej, është lidhur edhe kontrata e kredisë konsumatore në datën 7.10.2016 me të njëjtin qëllim për mobilim.

⁸ Shihni përgjigjet nr. 3 dhe nr. 4, datë 14.10.2021, mbi pyetësin e datës 6.10.2021.

⁹ Shihni përgjigjet nr. 3, datë 14.10.2021, për pyetësin e datës 11.10.2021.

¹⁰ Shihni pyetësin e datës 6.10.2021.

¹¹ Shihni shkresën nr. *** prot., datë 4.11.2021, të Credins Bank.

22.5 Nga lëvizjet e llogarisë rezulton se kështu mujore të kredisë janë paguar rregullisht me derdhje *cash* të kryera nga bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit, z. R. H. dhe, për këtë arsye, këto janë përfshirë si shpenzime në analizën financiare të subjektit të rivlerësimit.

22.6 Në lidhje me mosdeklarimin e qëllimit të detyrimit financiar në Deklaratën *Vetting*, shpenzimet e pretenduara për riparime/këste dhe shumën e mbajtur gjendje *cash* në banesë me burim nga kjo kredi, subjekti prapësoi se: *“... për arsyen e marrjes së kësaj kredie, e cila referuar edhe vetë llojit të kredisë, është një kredi konsumatore e marrë nga ana ime, përkatësisht për riparime dhe rregullime të banesës në të cilën unë banoj. Për sa i përket shumës së shpenzimeve për këto rregullime, isha në pamundësi objektive të bëja një llogaritje të tillë, pasi gjatë kohës që po merresha me rregullimet e cituara më lart, kam plotësuar Deklaratën *Vetting*, pjesën tjetër të mbajtur *cash* e kam përdorur për shlyerjen e kësteve të kredisë.... kredia e marrë nga ana ime në datën 7.10.2016 pranë Credins Bank është përdorur për riparime/rregullime të banesës me qira ku banoj. Kjo shumë nuk është përdorur për mobilim, duke përfshirë edhe pajisjet elektrike”*.

22.7 Komisioni nuk ka konstatuar problematika të tjera për hetime të mëtejshme lidhur me procesin e rivlerësimit kalimtar.

23. Kredi konsumatore në shumën 700.000 (shtatëqind mijë) lekë në Credins Bank
Bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit ka deklaruar në Deklaratën *Vetting* se ka përfituar prej Credins Bank një kredi bankare në shumë fillestare 700.000 (shtatëqind mijë) lekë, me detyrim të mbetur shumën 72.815 (shtatëdhjetë e dy mijë e tetëqind e pesëmbëdhjetë) lekë, por nuk deklaroi arsyen e marrjes së saj dhe as mënyrën si është përdorur ajo.

Hetimi i kryer nga Komisioni

23.1 Komisioni e ka pyetur subjektin e rivlerësimit për qëllimin e marrjes së kredisë nga bashkëshorti i saj në Credins Bank, ku në përgjigje ajo sqaron se: *“Kjo kredi është marrë për të mbuluar shpenzime, të cilat bashkëshorti im i ka bërë për disa riparime për automjetin që kishim, pjesën e mbetur e ka mbajtur *cash*, duke e përdorur për pagimin e kësteve të kredisë. Gjithashtu, ju sqaroj se kjo kredi e marrë nga bashkëshorti im është kredi konsumatore (personale), është shlyer brenda afateve të parashikuara në kontratën mes tij, si debitor dhe Credins Bank si kreditor”*.

23.2 Credins Bank¹² ka përcjellë për Komisionin kontratat e nënshkruara midis palëve dhe praktikën e aprovimit të kredisë. Në sa vijon, rezultoi se është lidhur kontrata e kredisë në datën 26.2.2014, me kredimarrës R. H. dhe dorëzuesin subjektin e rivlerësimit dhe shtetasin A. V. V.. Bazuar në raportin e analizës së kryer nga banka është deklaruar si qëllim i marrjes së kredisë blerja e një automjeti tip “***” në Itali, i cili kushton 4.500 (katër mijë e pesëqind) euro, si dhe për pagesën e pjesës së shpenzimeve doganore në vlerën 70.000 (shtatëdhjetë mijë) lekë.

23.3 Nga verifikimi në sistemin AMF nuk rezultojnë automjete tip “***” në pronësi apo përdorim të subjektit të rivlerësimit dhe bashkëshortit të saj.

23.4 Komisioni i kërkoi subjektit shpjegime për faktin se nuk është deklaruar nga bashkëshorti i saj vlera e detyrimit të mbetur dhe qëllimi i kreditimit, që, me sa rezultoi nga hetimi, qëllimi i kreditimit i deklaruar në kontratën e kredisë bankare nuk përputhet me faktin.

23.5 Subjekti rivlerësimit në prapësime ka shpjeguar gjithashtu se: *... kjo kredi e marrë nga bashkëshorti im është një kredi, e cila është marrë jashtë periudhës së rivlerësimit, duke kërkuar që ajo mos i nënshtrohet vlerësimit nga Komisioni.*

23.6 Komisioni vëren se subjekti nuk i ka adresuar pyetjet që i janë drejtuar dhe nuk është bindëse në përgjigjet e saj. Gjithsesi, pa dashur të penalizojë subjektin, Komisioni vlerëson se

¹² Shihni shkresën nr. *** prot., datë 4.11.2021, të Credins Bank.

mosdeklarimi i qëllimit të kreditimit dhe vlerës së detyrimit të mbetur mund të ketë ardhur nga padijenja ose neglizhenca.

22.8 Nuk janë konstatuar problematika të tjera, për hetime të mëtejshme lidhur me procesin e rivlerësimit kalimtar.

23 GJETJE TË TJERA

23.1 Subjekti i rivlerësimit ka deklaruar në pyetësonin standard shpenzime udhëtimi dhe shpenzime për arsimin e fëmijës, të cilat janë mbuluar nga babai dhe nëna e bashkëshortit të subjektit të rivlerësimit (shpenzimet e udhëtimit dhe arsimimit janë jashtë periudhës së rivlerësimit).

23.2 Sipas deklarimit në pyetësonin standard, shpenzimet për udhëtim, përkatësisht në datën 10.7.2017 në vlerën 1.100 (njëmijë e njëqind) euro janë dhuruar prej vjehrrit të saj. Subjekti ka deklaruar gjithashtu se në datën 14.6.2019 vjehri i saj ka paguar shpenzimet totale prej 1.500 (njëmijë e pesëqind) euro. Si burim i pagesave kanë shërbyer të ardhurat nga aktiviteti privat i familjes H..

23.3 Në pyetësonin standard, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar se djali i saj prej vitit shkollor 2017 e në vazhdim studion në shkollën jopublike “****”. Shpenzimet¹³ për shkollimin e djalit të subjektit janë mbuluar nga prindërit e bashkëshortit.

23.4 Subjekti i rivlerësimit ka depozituar pranë Komisionit¹⁴ dokumentacion provues për të ardhurat e prindërve të bashkëshortit të saj.

23.5 QKB-ja ka informuar¹⁵ Komisionin se shtetasi G. H. është regjistruar si person fizik në datën 23.12.2014, me NIPT ***, për ushtrim aktiviteti “****” dhe se statusi i aktivitetit tregtar figuron i çregjistruar¹⁶ në datën 10.7.2015, si dhe konfirmon se shtetasi G. H. figuron të ketë qenë administrator i shoqërisë aksionare “****” deri në datën 4.4.2012 dhe figuron aksionar zotërues deri në 3% të aksioneve në shoqërisë aksionare “****” deri në datën 11.2.2014, kur është larguar nga struktura aksionare e kësaj shoqërie.

23.6 QKB-ja ka informuar¹⁷ Komisionin se shtetasja Sh. H. është regjistruar si person fizik¹⁸ në datën 4.2.2015 për veprimtarinë “****” sh.p.k. (prodhim dhe tregtim fruta, perime, mbarështim dhe rritje blegtorie dhe shpendë të llojeve të ndryshme, bar, restorant, hipizëm, peshkim, shëtitje me varka, hoteleri, aktivitete sportive etj.) në ***, Durrës.

23.7 Drejtoria Rajonale Tatimore ka¹⁹ konfirmuar për Komisionin se tatimpaguesi “Sh. H.”, person fizik, ka paguar sigurimet shoqërore, tatim mbi të ardhurat personale dhe TVSH prej vitit 2015.

23.8 Nga hetimi i kryer nga Komisioni rezulton se shtetasit G. H. dhe Sh. H. janë pronarë të disa pasurive të paluajtshme në Durrës dhe Tiranë të regjistruara në pronësi të tyre para vitit 2016.

23.9 Në përfundim ka rezultuar se familja e prindërve të bashkëshortit të subjektit, disponon aktivitete tregtare²⁰, si dhe pasuri të ndryshme, të cilat nuk i shikon të lidhura me subjektin e rivlerësimit dhe procesin e saj rivlerësues, gjithashtu ata disponojnë të ardhura dhe likujditete të mjaftueshme për të mbuluar shpenzimet e deklaruara nga subjekti i rivlerësimit, në kuadër të këtij procesi.

¹³ Shihni përgjigjen në pyetësonin e datës 5.10.2021.

¹⁴ Shihni dokumentacionin paraqitur me pyetësonin e datës 1.11.2021.

¹⁵ Shihni shkresën nr. *** prot., datë 25.9.2020, të QKB-së.

¹⁶ QKB-ja, me shkresën nr. *** prot., datë 13.7.2017, ka konfirmuar për ILDKPKI-në se shtetasi G. H., i datëlindjes 15.4.1956, figuron i regjistruar si person fizik me NUIS (NIPT) ***. Aktualisht me status çregjistruar.

¹⁷ Shihni shkresën nr. *** prot., datë 25.9.2020, të QKB-së.

¹⁸ QKB-ja konfirmon për ILDKPKI-në se shtetasja Sh. H., e datëlindjes 15.4.1956, figuron të jetë si person fizik me NUIS (NIPT) ***, me status – aktiv, me aktivitet “veprimtari ****” (Aneks nr. ***).

¹⁹ DPT-ja me shkresën nr. *** prot., datë 30.9.2020.

²⁰ Shihni shkresën nr. *** prot., datë 25.9.2020, të QKB-së, ku vërtetohet se shtetasi G. H. figuron i regjistruar si person fizik më 23.12.2014, me NIPT *** për ushtrim aktiviteti “****” në Durrës.

23.10 Ministria e Drejtësisë, Zyra e Regjistrimit Noterial, ka dërguar të dhëna lidhur me veprime noteriale të kryera nga bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit, ku ka rezultuar se shtetasi R. H. ka firmosur një Kontratë Kreditimi Hipotekimi nr. *** rep., nr. *** kol., datë 14.12.2016, pranë noterës I. I. T..

23.11 Zyra noteriale, me shkresën nr. *** prot., datë 7.10.2021, ka vendosur në dispozicion të Komisionit Kontratën për Kreditim me Kusht dhe Hipotekim nr. *** rep., nr. *** kol., datë 14.12.2016, lidhur ndërmjet ProCredit Bank sh.a. dhe shtetases Sh. H., ku bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit, z. R. H., ka firmosur në cilësinë e debitorit solidar dhe jo në cilësinë e hipotekuesit.

23.12 Komisioni i ka kërkuar subjektit shpjegime lidhur me mosdeklarimin nga ana e bashkëshortit në Deklaratën *Vetting* të detyrimit solidar që ai ka marrë përsipër gjatë periudhës së rivlerësimit.

23.13 Subjekti ka shpjeguar: *“Në Deklaratën Vetting nuk është deklaruar nga bashkëshorti im se ka nënshkruar në cilësinë e debitorit solidar, pasi është menduar nga ana e tij se në Deklaratën Vetting duhej të deklaroheshin kredi të marra nga ai si person fizik/juridik. Nga kontrata e kredisë midis ProCredit Bank dhe znj. Sh. H. (kredi që tashmë është blerë nga OTP Bank Albania, në rolin e kredidhënësit) është cilësuar se z. R. H. ka firmosur në cilësinë e debitorit solidar dhe jo në cilësinë e hipotekuesit. Përfshirja si dorëzanës është politikë e bankave të nivelit të dytë, ku në rast se kredimarrësi gjatë periudhës së shlyerjes së kredisë është mbi moshën 65 vjeç, duhet të ketë një person nën moshën 65 vjeç të nënshkruajë si debitor solidar, kusht i vendosur nga banka për marrjen e kredisë. Duke qenë se kredimarrësi Sh. H., nëna e bashkëshortit tim, gjatë kohëzgjatjes së shlyerjeve të kësteve të kredisë kalon moshën 65 vjeç, është vendosur kusht nga kredidhënësi që kjo kontratë kredie të firmoset si dorëzanës nga bashkëshorti im, duke bërë edhe policë sigurimi në emër të tij. Kjo kredi është marrë nga shtetasja Sh. H., nëna e bashkëshortit tim, me qëllim biznesi dhe si person tregtar (PF), si dhe duke qenë një kredi që nuk është marrë nga bashkëshorti im ose në funksion të tij, ai ka vlerësuar se nuk duhej ta deklaronte në Deklaratën Vetting”.*

23.14 Subjekti ka bashkëlidhur me këto prapësime Kontratën e Kredisë Bankare nr. *** rep., nr. *** kol., datë 26.8.2021, nënshkruar mes OTP Bank Albania si kredidhënëse dhe kredimarrëse Sh. H., dorëzanës R. H. e G. H.. Subjekti shpjegon se kjo kontratë ka përthithur kontratën e mëparshme të kredisë të vitit 2016, lidhur me ProCredit Bank.

23.15 Komisioni konstatoi se në përmbajtje të kësaj kontrate kredie nuk ka referenca të kontratës së mëparshme të kredisë së nënshkruar me ProCredit Bank. Vlera e lëvruar e kredisë nëpërmjet kësaj kontrate kredie është 60.000.000 (gjashtëdhjetë milionë) lekë dhe qëllimi është për investim në asete fikse.

23.16 Komisioni vëren se detyrimi i lindur në bazë të Kontratës së Kredisë Bankare nr. *** rep., nr. *** kol., datë 26.8.2021, nënshkruar mes OTP Bank Albania dhe shtetasve Sh. H., R. H. dhe G. H. është i ndryshëm nga detyrimi në bazë të Kontratës së Kreditimit dhe Hipotekimit nr. *** rep., nr. *** kol., datë 14.12.2016, të konstatuar gjatë hetimit, e cila është lidhur mes ProCredit Bank dhe palëve Sh. H., R. H. dhe G. H.. Këto detyrime janë të ndryshme si për nga vlera, qëllimi i kreditimit apo kolaterali i vendosur. Shtetasi R. H., edhe në Kontratën e vitit 2021 me OTP Bank Albania, paraqitet në cilësinë e dorëzanësit, ku rezulton që ky të jetë detyrim i lindur pas periudhës së rivlerësimit.

23.17 Mosdeklarimi i detyrimit solidar për Kontratën e Kredisë nr. *** rep., nr. *** kol., datë 14.12.2016, nga ana e bashkëshortit të subjektit të rivlerësimit në Deklaratën *Vetting* mbetet i paargumentuar dhe i paarsyetuar. Në vlerësim të të gjitha rrethanave, Komisioni arsyeton se deklarimi nuk është i saktë në përputhje me ligjin, por jo në masë të tillë sa të penalizojë subjektin, përderisa detyrimi, edhe pse rëndon mbi bashkëshortin e subjektit të rivlerësimit, nuk është marrë për qëllime të aktivitetit të tij.

23.18 Në vlerësim të fakteve dhe rrethana trupi gjykues cmon se nuk konstaton problematika të tjera, duke mos patur dyshime për hetime të mëtejshme që lidhen me subjektin e rivlerësimit.

23.19 Ministria e Drejtësisë, Zyra e Regjistrimit Noterial, ka dërguar të dhëna për veprimet noteriale të bashkëshortit të subjektit të rivlerësimit, ku rezulton se shtetasi R. H. ka lidhur një Kontratë Qiraje nr. *** rep., nr. *** kol., datë 23.9.2016, në Zyrën Noteriale të noteres G. A. D..

23.20 Njëpërmjet shkresës nr. *** prot., datë 7.10.2021, është përcjellë pranë Komisionit Kontrata e Qirasë nr. *** rep., nr. *** kol., lidhur ndërmjet qiradhënësit R. F. A. dhe qiramarrësit R. G. H., nga ku rezulton se shtetasi R. G. H. ka nënshkruar këtë kontratë qiraje me shtetasin R. F. A.. Objekti i kësaj kontrate ka qenë dhënia me qira e një pasurie me nr. ***, e cila ndodhet në zonën kadastrale ***, kati përdhe, sipas Lejes së Legalizimit nr. ***, datë 25.6.2013, nga e cila jepet vetëm një pjesë e kësaj pasurie prej 57 m² sipërfaqe e brendshme, bashkë me lulishten, pjesa e pasme e lokalit dhe pjesa e kuzhinës. Bashkëlidhur kontratës së qirasë gjendet Leja e Legalizimit nr. ***, datë 25.6.2013, për godinë banimi dy kate në emër të shtetasit H. B. Z..

23.21 Bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit nuk ka deklaruar në Deklaratën *Vetting* marrjen me qira të këtij ambienti dhe as pagesa të mundshme të qirasë.

23.22 Në vijim, subjekti sqaron²¹ për Komisionin arsyen e mosdeklarimit prej saj dhe bashkëshortit të kontratës noteriale të lidhur: “...bashkëshorti im ka ndërmarrë iniciativë për hapjen e një biznesi (lokali), për të cilin ka ndërmarrë veprimin për sigurimin e një ambienti me qira për zhvillimin e biznesit. Në lidhje me këtë iniciativë ka lidhur paraprakisht Kontratën e Qirasë nr. *** rep., datë 23.9.2016, me qëllimin e ushtrimit të aktivitetit tregtar në këtë ambient. Por, pavarësisht se e ka lidhur një kontratë të tillë, kjo kontratë nuk është ekzekutuar, pasi nuk ka pasur dakordësi me qiradhënësin në lidhje me një investim që donte të ndërmerre e, për pasojë, kjo kontratë është pushuar. Kontrata e Qirasë nr. *** rep., datë 23.9.2016, është një kontratë që është shuar me vullnetin e të dyja palëve, për rrjedhojë është një kontratë që ka humbur rëndësinë e veprimit juridik për çfarë ishte lidhur, duke çuar në shuarjen e veprimit juridik. Për rrjedhojë, duke qenë një kontratë që nuk është ekzekutuar asnjëherë nga palët që e kanë lidhur (e cila është shuar), nuk është deklaruar nga ana ime. Nga ajo çfarë më ka informuar bashkëshorti im është se qiradhënësi në fjalë me kërkesën e tij, pas një periudhe kohore, për të shmangur pengesat ligjore për dhënien e pronës së tij me qira, bashkë me bashkëshortin tim, i janë drejtuar noterit pranë të cilit ishte lidhur kjo kontratë qiraje për prishjen e saj. Kjo vjen edhe për faktin se kjo kontratë qiraje nuk është ekzekutuar nga palët, është shuar dhe të mos bëhet pengesë për interesat e ardhshme të qiradhënësit”.

23.23 Subjekti i rivlerësimit sqaron²² për Komisionin se nuk disponon ndonjë dokumentacion provues për prishjen e kontratës, pasi kjo kontratë qiraje nuk është ekzekutuar nga palët, është prishur, duke mos pasur asnjë vlerë juridike dhe, për këtë arsye, nuk ka mbajtur kopje të kontratës apo të prishjes së saj.

23.24 Subjekti ka paraqitur në prapësime Deklaratë Noteriale nr. *** rep., nr. *** kol., datë 12.7.2022, të shtetasit R. F. A., me të cilin shtetasi R. H. kishte nënshkruar Kontratën e Qirasë nr. *** rep., nr. *** kol., datë 23.9.2016. Njëpërmjet kësaj deklarate, qiradhënësi R. A. deklaroi se është lidhur kontrata e qirasë me të dhënat e mësipërme mes tij dhe shtetasit R. H., me objekt “Pasuria banesë nr. ***, me sipërfaqe 57 m²”. Kjo kontratë nuk është ekzekutuar nga palët e kontratës dhe është bërë kthimi i tyre në gjendjen e mëparshme. Shtetasi R. A. deklaroi se nuk është paguar asnjë këst i qirasë, objekti është dorëzuar tek qiradhënësi dhe se kontrata është revokuar brenda muajit, por nuk disponohen kopje fizike të aktit të revokimit.

23.25 Në vlerësim të fakteve dhe rrethana trupi gjykues cmon se nuk konstaton problematika të tjera, duke mos patur dyshime për hetime të mëtejshme që lidhen me subjektin e rivlerësimit.

²¹ Shihni përgjigjen nr. 1, datë 14.10.2021, në pyetësorin e datës 11.10.2021.

²² Shihni përgjigjen nr. 4, në pyetësorin e datës 1.11.2021.

24 Në përfundim të vlerësimit të kriterit të pasurisë, trupi gjykues konkludon se pavarësisht disa gjetjeve lidhur me mosdeklarime apo pasaktësi në deklarimet e subjektit të rivlerësimit, nuk ka rrethana të tilla që mund të cenojnë kriterin e vlerësimit të pasurisë apo procesin në tërësi të rivlerësimit të subjektit. Në konkluzionin përfundimtar, trupi gjykues është bazuar në aplikimin e parimit të proporcionalitetit, duke vënë në balancë rrethanat e konstatuara të lidhura me pasuri të krijuara para detyre, në mungesë të kontributit financiar nga subjekti, si dhe në mosevidentimin e ndonjë rrethane tjetër për deklarim të rremë, fshehje pasurie apo që të ardhurat të jenë rrjedhojë e ndonjë veprimtarie të kundërligjshme, që mund të cenonte pozitën e saj në këtë proces.

Për sa u arsyetua më sipër, konsideruar gjithashtu funksionin e saj si ndihmëse ligjore dhe periudhën e ushtrimit të kësaj detyre prej saj gjatë periudhës së rivlerësimit kalimtar dhe në nivelin e rrethanave specifike të rezultuara për këtë subjekt, vlerësohen nga trupi gjykues se nuk cenojnë qëllimin e ligjit që normon procesin e rivlerësimit kalimtar. Ky konkluzion i trupit gjykues është në koherencë edhe me vendimin e Gjykatës Evropiane të Drejtave të Njeriut (GJEDNJ) S vs Albania, paragrafin 96.

Për sa më sipër, trupi gjykues vlerëson se subjekti i rivlerësimit, znj. Jurida Bajraktari, ka një nivel të besueshëm në vlerësimin e pasurisë, sipas parashikimit të shkronjës “a” të nenit 59/1 të ligjit nr. 84/2016.

B. KONTROLLI I FIGURËS

25 Autoriteti Kombëtar për Sigurinë e Informacionit të Klasifikuar (AKSIK) ka kryer kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit me anë të verifikimit të deklarimeve dhe të dhënave të tjera, me qëllim që të identifikonte nëse subjekti i rivlerësimit ka kontakte të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin DH të Aneksit të Kushtetutës dhe ligjin nr. 84/2016.

26 Komisioni i ka kërkuar AKSIK-së deklasifikimin dhe përditësimin e informacionit lidhur me subjektin e rivlerësimit, znj. Jurida Bajraktari, përderisa raporti pararendës kishte kryer verifikimet deri në datën 30.10.2017. AKSIK-ja, me shkresën nr. *** prot., datë 26.11.2021, ka deklasifikuar raportin, duke konstatuar përshtatshmërinë për vazhdimin e detyrës të subjektit të rivlerësimit, znj. Jurida Bajraktari.

27 Komisionit nuk i kanë rezultuar të dhëna apo *indicie* të tjera për këtë subjekt rivlerësimi.

28 Për sa më sipër, trupi gjykues vlerëson se subjekti i rivlerësimit, znj. Jurida Bajraktari, ka arritur një nivel të besueshëm në kontrollin e figurës, sipas parashikimit të shkronjës “b” të nenit 59/1 të ligjit nr. 84/2016.

C. VLERËSIMI I AFTËSIVE PROFESIONALE

29 Vlerësimi i aftësive profesionale nga Komisioni është bazuar në: (a) raportin për analizimin e aftësisë profesionale të subjektit të rivlerësimit të kryer nga KLGJ-ja; (b) kriteret e vlerësimit të parashikuara në nenin 165 e vijues të ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”; (c) dokumentacionin e mbledhur nga Komisioni gjatë hetimit administrativ.

30 Në mbështetje të pikës 2 të nenit 42 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, ndihmësit ligjorë pranë gjykatave administrative vlerësohen bazuar në:

- a) relacionet dhe mendimet ligjore të përgatitura;
- b) rezultatet e testimit pranë Shkollës së Magjistraturës.

31 Lidhur me kriterin e parë vlerësues, relacionet dhe mendimet ligjore të përgatitura

31.1 Tri dokumentet ligjore të paraqitura nga subjekti i rivlerësimit përbëhen nga një relacion, një vendim për kalimin e çështjes për shqyrtim në seancë gjyqësore dhe një draft vendimi përfundimtar. Të tria këto dokumente i përkasin vitit 2016. Këshilli i Lartë Gjyqësor, në raportin që i ka përcjellë Komisionit, ka konkluduar se relacionet janë më tepër në kuptimin e një përshkrimi të vendimmarrjes së gjykatës së shkallës së parë dhe parashtrimit të pretendimeve të ngritura në ankim nga pala paditëse. Nuk ka mendim konkret të ndihmësit ligjor për zgjidhjen e çështjes.

31.2 Nga pesë dokumentet ligjore të përzgjedhura me short rezultoi se në asnjë prej dosjeve gjyqësore nuk kishte ndonjë akt kërkimi ligjor apo opinion me shkrim nga vetë ndihmësja ligjore Jurida Bajraktari, që të mund të vlerësohej nga Komisioni aspekti i njohurive ligjore, aftësia për të interpretuar ligjin apo për të identifikuar konfliktin e normave.

31.3 Në vijim të propozimeve të saj, subjekti i rivlerësimit ka shpjeguar për Komisionin se ka kryer të gjitha detyrat e caktuara nga gjyqtarja, pranë së cilës ka ushtruar detyrën dhe se asnjëherë nuk i është kërkuar prej saj dhënia e ndonjë mendimi konkret lidhur me zgjidhjen e çështjes.

31.4 Në çmim të dokumentacionit të administruar dhe shpjegimeve të dhëna nga subjekti, rezulton se ajo është përpjekur të justifikohet me faktin se ka bërë aq sa i ka kërkuar gjyqtarja, por ky justifikim nuk mund të mbulojë mungesën e arsytimit ligjor në dokumente.

31.5 Për sa i përket mosadministrimit në pesë dosjet e përzgjedhura me short të dokumenteve të përgatitura nga ndihmësi ligjor, subjekti i rivlerësimit ka shpjeguar për Komisionin se çështjet e punuara nga ndihmësi ligjor përgatiteshin paraprakisht përpara se ato të shpalleshin për gjykim dhe e gjithë kjo procedurë e kryer nga ndihmësi ligjor nuk rezulton të jetë plotësuar me ndonjë akt nënligjor apo me ndonjë rregullore të brendshme nga ana e gjykatës, si pasojë e natyrës së ndihmësit dhe vakumit ligjor të sjellë nga ligji nr. 49/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatave Administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, i ndryshuar.

31.6 Komisioni vlerësoi se aftësitë profesionale të subjektit mbështeten në analizimin e projektakteve të hartuara prej saj në çmuarje të burimeve të rivlerësimit sipas nenit 42 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”. Për rrjedhojë, Komisioni konstatoi se tri dokumentet ligjore janë akte formale dhe nga ana përmbajtësore nuk paraqesin të dhëna mbi aftësitë profesionale të subjektit lidhur me interpretimin dhe zbatimin e ligjit, si dhe nuk tregojnë mendime/sugjerime/rekomandime të dhëna nga ndihmësi ligjor për zgjidhjen e çështjes.

31.7 Në rrethanat kur nga vlerësimi i raportit të përgatitur nga KLGJ-ja për subjektin e rivlerësimit Komisioni ka pasur vështirësi të arrijë në një konkluzion mbi aftësitë personale dhe angazhimin profesional, i kërkoi subjektit të paraqesë dokumente ligjore (5-10 relacione) të përgatitura prej saj gjatë ushtrimit të detyrës.

31.8 Subjekti i rivlerësimit ka vënë në dispozicion të Komisionit 9 akte, nga vlerësimi i të cilave rezultoi se ato janë dokumente formale dhe në përmbajtje nuk reflektojnë tregues mbi aftësinë për arsytimin ligjor e gjykim të drejtë, sipas parashikimeve të ligjit nr. 49/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatave Administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, i ndryshuar.

31.9 Trupi gjykues i Komisionit arriti në konkluzionin se nga vlerësimi i raportit të përgatitur nga KLGJ-ja për subjektin e rivlerësimit, shpjegimet e dhëna prej saj dhe dokumentacioni i administruar gjatë hetimit, dukshëm subjekti nuk ka reflektuar qartësi në arsytim, madje në shumë raste ai mungon tërësisht, çka krijon bindjen se subjekti i rivlerësimit, në pozicionin e ndihmësit ligjor, nuk arriti nivel kualifikues të vlerësimit të aftësive profesionale si në aspektin e njohurive të saj ligjore apo aftësive profesionale. Në materialet e përgatitura prej saj nuk janë identifikuar tregues të tillë si, aftësia për të interpretuar ligjin, për të identifikuar konfliktin e normave apo aftësia për të analizuar jurisprudencën.

32 Lidhur me kriterin e dytë vlerësues, rezultatet e testimit pranë Shkollës së Magjistraturës

32.1 Shkolla e Magjistraturës, me shkresën nr. *** prot., datë 23.5.2018, ka vendosur në dispozicion të Komisionit rezultatet e testimit të aftësive profesionale për subjektet e rivlerësimit *ex officio*, të parashikuara në pikën 4 të nenit 179/b²³ të Kushtetutës dhe sipas parashikimeve të nenit 42²⁴ të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

32.2 Nga verifikimi i tabelave të rezultateve u konstatua se në fazën e parë të testimit të aftësive profesionale, subjekti ka fituar 44 pikë nga 100 pikë në total, ndërsa në fazën e dytë ka fituar 132 pikë nga 200 pikë në total, duke mos u përzgjedhur për të ndjekur formimin fillestar pranë Shkollës së Magjistraturës, në bazë të ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

32.3 Duke qenë se testi në Shkollën e Magjistraturës është një kriter vlerësimi, në kuadër të vlerësimit profesional të subjektit Jurida Bajraktari, Komisioni vlerësoi se ajo ka përfituar një vlerësim në këtë test.

33 Komisioni ka hetuar mbi përvojën profesionale të subjektit të rivlerësimit, aftësitë profesionale dhe eksperiencën e znj. Jurida Bajraktari, si dhe plotësimin prej saj të përvojës profesionale të kërkuar për ushtrimin e detyrës së ndihmësit ligjor në Gjykatën Administrative të Apelit. Ky verifikim është kryer në kuadër të disa të dhënave në formë indicjesh, të mbledhura gjatë hetimit.

34 Nga hetimi administrativ i kryer për shkak të procesit të rivlerësimit, si dhe verifikimi i dokumentacionit dhe shpjegimeve të subjektit për Komisionin, rezultoi se subjekti i rivlerësimit, znj. Jurida Bajraktari, nuk përmbushte kushtin e përvojës në punë për të aplikuar në pozicionin e ndihmësit ligjor në Gjykatën Administrative të Apelit, sipas parashikimeve ligjore. Trupi gjykues, në kuadër të vlerësimit të aftësive profesionale të subjektit, ka vlerësuar ta pyesë atë se pse ka aplikuar, kur dukej se ka qenë në kushtet e mospërmbushjes në mënyrë kumulative të kriterit ligjor.

35 Subjekti i rivlerësimit ka dhënë shpjegimet e saj, të cilat në vlerësim të trupit gjykues kanë krijuar bindjen se eksperiencën e punës së znj. Jurida Bajraktari nuk ka qenë në harmoni me kërkesat ligjore që kërkojnë përvojë profesionale si jurist në: organet e sistemit të drejtësisë; funksione publike në administratën e Kuvendit; administratën e institucionit të Presidentit; aparatin e Këshillit të Ministrave; ministri dhe institucione qendrore të pavarura; Gjykatën Kushtetuese dhe Gjykatën e Lartë; prokurorinë, si avokat apo si personel akademik i Fakultetit të Drejtësisë të Universitetit të Tiranës.

36 Trupi gjykues i çmoi edhe këto mangësi, pa dashur të ndërhyjë në gjykimin e komitetit *ad hoc*, pjesë e mungesës së duhur të formimit profesional dhe aftësive të saj për të identifikuar konfliktin e normave apo aftësinë për të analizuar jurisprudencën dhe, më tej, aftësinë për të përgatitur opinione të karakterit procedural apo edhe material për çështjet në gjykim.

37 Trupi gjykues i Komisionit, i mbledhur në dhomë këshillimi, çmoi në tërësi problematikat e konstatuara dhe vlerësoi se subjekti i rivlerësimit ka shfaqur një nivel të dobët arsyetimi dhe gjykimi e me mangësi, por çmoi se ato janë të tilla që të mund të plotësohen nëpërmjet programit të trajnimit për ndihmës ligjor në Shkollën e Magjistraturës.

38 Në vijim, me vendimin e ndërmjetëm nr. 496 akti, nr. 5 vendimi, datë 20.7.2022, u vendos: “Pezullimi nga detyra i znj. Jurida Bajraktari, për një periudhë njëvjeçare, me detyrimin për të ndjekur programin e trajnimit, sipas kurrikulave të miratuara nga Shkolla e Magjistraturës”.

²³ Të gjithë këshilltarët ligjorë pranë Gjykatës Kushtetuese dhe Gjykatës së Lartë, ndihmësit ligjorë pranë gjykatave administrative, si dhe ndihmësit ligjorë pranë Prokurorisë së Përgjithshme do të rivlerësohen *ex officio*.

²⁴ Këshilltari ligjor i Gjykatës Kushtetuese, ndihmësi ligjor i Gjykatës së Lartë, Gjykatës Administrative, si dhe ndihmësi ligjor në Prokurorinë e Përgjithshme, të cilët nuk janë magjistratë, vlerësohen bazuar në: (a) relacionet dhe mendimet ligjore të përgatitura; (b) rezultatet e testimit pranë Shkollës e Magjistraturës.

39 Në përfundim të këtij trajnimi, me shkresën nr. *** prot., datë 21.7.2023, Shkolla e Magjistraturës ka dërguar në Komision rezultatet e provimit përfundimtar të subjektit të rivlerësimit, bazuar në pikën 2 të nenit 60 të ligjit nr. 84/2016.

40 Bazuar në rezultatet e arritura, të miratuara nga Këshilli Pedagogjik, si dhe Këshilli Drejtues i Shkollës së Magjistraturës, me vendimin nr. ***, datë 18.7.2023, konstatohet se subjekti i rivlerësimit, znj. Jurida Bajraktari, është vlerësuar “mirë” në testimin përfundimtar, duke tejkaluar mangësitë e parashtruara në vendimin e Komisionit të Pavarur të Kualifikimit.

41 Për sa rezultoi më sipër, trupi gjykues arriti në përfundimin se subjekti i rivlerësimit ka një nivel kualifikues në vlerësimin e aftësive profesionale, sipas parashikimit të shkronjës “c” të nenit 59/1 të ligjit nr. 84/2016.

PËR KËTO ARSYE,

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, bazuar në pikën 5 të nenit 55 të ligjit nr. 84/2016, pasi u mblodh në dhomë këshillimi, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, duke çmuar që subjekti ka arritur një nivel të besueshëm në vlerësimin e pasurisë, një nivel të besueshëm në kontrollin e figurës si dhe një nivel kualifikues në vlerësimin e aftësive profesionale pas përfundimit të trajnimit njëvjeçar të Shkollës së Magjistraturës, duke mënjanuar mangësitë e konstatuara, në bazë të nenit 58, pika 1, shkronja “a”, nenit 59, pika 1 dhe të nenit 60, pika 2 e ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”,

V E N D O S I:

- 1.** Konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimit, znj. Jurida Bajraktari, ndihmëse ligjore në Gjykatën Administrative të Apelit Tiranë.
- 2.** Vendimi, i arsyetuar me shkrim, u njoftohet subjektit të rivlerësimit, Komisionerit Publik dhe vëzhguesve ndërkombëtarë brenda 30 ditëve pas përfundimit të seancës dëgjimore dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit, në përputhje me pikën 7 të nenit 55 të ligjit nr. 84/2016.
- 3.** Ky vendim ankimohet pranë Kolegjit të Posaçëm të Apelit nga subjekti i rivlerësimit dhe/ose Komisioneri Publik 15 ditë nga data e njoftimit të vendimit.
- 4.** Ankimi depozitohet në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit.

U shpall në Tiranë, në datën 25.9.2023.

ANËTARËT E TRUPIT GJYKUES

Genta TAFA (BUNGO)
Kryesuese

Valbona SANXHAKTARI
Relatore

Lulzim HAMITAJ
Anëtar

Sekretare gjyqësore
Elda Faruku